



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr. 308/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Nehat Idrizi dhe Vlastimir Dimić, duke vendosur lidhur me apelin Cvejić Jelena në cilësinë e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Srpska Socijaldemokratska Stranka, për tu tërhequr nga lista e kandidatëve për deputete të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë apeli si i pasafatshëm.

## A R S Y E T I M

Cvejić Jelena, në cilësinë e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Srpska Socijaldemokratska Stranka, ka parashtruar apel për tu tërhequr nga lista e kandidatëve për parlament të Republikës së Kosovës, sipas parashtrueses së ankesës ajo nuk e ka nënshkruar deklaratën për të qenë pjesë e subjektit politik Srpska Socijaldemokratska Stranka, po ashtu sipas parashtrueses së ankesës nëse figuron nënshkrimi i saj në atë dokument atëherë më përgjegjësi të plotë deklaroi se është i falsifikuar.

## F A K T E T

PZAP ka pranuar një apel më datë 01.12.2010, nga Cvejić Jelena në cilësinë e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Srpska Socijaldemokratska Stranka, e cila me apel kërkon nga PZAP-i tërheqjen nga lista e kandidatëve për deputete nga subjekt i lartë cekur politik. Duke pasur parasysh se me këtë rast ju është bërë e padrejtë ngase sipas parashtrueses së apelit ajo gjendet në listën për candidate të deputetes për Kuvendin e Republikës së Kosovës pa dijen e saj dhe po ashtu parashtruesja thekson në apel, se është dëmtuar në këtë rast sepse paga e saj mujor është ulur dhe po ashtu kjo është në kundërshtim me përkrahimin e vendit të punës.

Parashtruesja e apelit propozon që PZAP-i të shqyrtoj apelin e saj dhe të bëjë tërheqjen nga lista e kandidatëve për Zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Kosovës.

## ANALIZË

Juridiksioni i PZAP-it lidhur me ankesat dhe parashtrësas është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligjin Nr. 03/ L-256, për ndryshimin dhe plotësimin e e ligjit Nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-072.

Neni 122 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së parasheh:

*Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli:*

*c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje.*

PZAP-i vlerëson se lista e kandidatëve konsiderohet e certifikuar në momentin kur KQZ-ja e tërheq shortin, kjo ka ndodhur më 20 nëntor 2010, në ora 17:00, nga dispozita e lart cekur rrjedh se afati për parashtrim të apelit ndaj vendimit të KQZ-së në PZAP në këtë fazë të procedurës është njëzetekatër (24) orë pas certifikimit. Nga shkresat e lëndës del se parashtruesja e apelit nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për apelim brenda afatit të caktuar në dispozitat e lartë cekura ligjore sepse PZAP-i e ka pranuar apelin më 01.12.2010, andaj PZAP-i konstaton se apeli është i pasafatshme e në kuptim më nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësas në Prishtinë**

A nr. 308/2010 më datën 02.12.2010

Kryesuesi i Panelit  
**Rafet Haxhaj**

